

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8275
E shtunë, 4 prill 2026
Çmimi 0.50 €

Mbyllet afati, 140 zyrtarë nuk e deklarojnë pasurinë

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

TAKIMET PËR PRESIDENTIN JAVËN E ARDHSHME, LV-ja: DO TË BËJMË ÇMOS QË TË SHMANGEN ZGJEDHJET

FAQE 4-5



Partitë kryesore politike në Kosovë ende nuk kanë bërë ndonjë lëvizje drejt arritjes së një marrëveshje të mundshme për zgjedhjen e presidentit të ri të vendit, pavarësisht se ka një

javë që po rrjedh afati rreth një-mujor i vendosur nga gjykata më e lartë e vendit për këtë çështje. Kryeministri i Kosovës dhe lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti, ka thënë të premtën se do

të ketë takime me liderët e opozitës javën e ardhshme për temën e presidentit. Zyrtarët e kësaj partie kanë theksuar se do të bëjnë çmos që t'i shmangen zgjedhjet e reja parlamentare



**QEVERIA E KOSOVËS
MIRATON PROJEKTLIGJIN
PËR ÇMIMET TAVAN DHE
ATË PËR SIGURIMET
SHËNDETËSORE** F. 3



**PUSHTETI
KUNDËRSHTON
KËRKESËN E OPOZITËS
PËR ULJEN E AKCIZËS
DHE HEQJEN TVSH-së
PËR NAFTËN** F. 6

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SPORT

**MIRATOHET PROJEKTLIGJI PËR
LOJËRAT MESHETARE 'PRISHTINA
2030'** F. 11

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878


SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OPINION

A NGOPET ALBIN KURTI? F. 6

Imer
MUSHKOLAJ



AKTUALE



**TRUMPI: SHBA-ja ENDE S'KA
FILLUAR MIRË TA SHKATËRROJË
IRANIN, REGJIMI DUHET
TË VEPROJË SHPEJT** F. 2

**ALARMI AMERIKAN
PËR SIGURINË NXIT MASA
TË REJA DHE PËRPLASJE
POLITIKE NË SHQIPËRI** F. 6

EKONOMI



**PROKURORIA AUTORIZON
POLICINË PËR GRUMBULLIMIN E
INFORMATAVE LIDHUR ME
NJEHSORËT E KEDS-it** F. 8

**TAKIMI I DELEGACIONEVE
KOSOVË - SHQIPËRI, FOKUSI NË
SIGURINË USHQIMORE DHE
UNIFIKIMIN E STANDARDEVE** F. 8

TRUMPI: SHBA-ja ENDE S'KA FILLUAR MIRË TA SHKATËRROJË IRANIN, REGJIMI DUHET TË VEPROJË SHPEJT

WASHINGTON, 3 PRILL - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka thënë se ushtria amerikane "ende nuk ka filluar" të shkatërrojë atë që ka mbetur prej Iranit pas një muaji bombardimesh së pareshtura shkatërruese, si dhe ka kërcënuar se do t'i godasë centralet elektrike dhe ura të tjera në paralajmërimin e tij më të fundit ndaj regjimit në Teheran. "Ushtria jonë, më e madhja dhe më e fuqishmja kudo në botë, ende nuk ka filluar ta shkatërrojë atë që ka mbetur në Iran. Tani është radha e urave, pastaj centraleve elektrike! Udhëheqja e re e regjimit e di se çfarë i duhet të bëjë dhe duhet ta bëjë, shpejt!" shkroi Trumpi në "Truth Social" mbrëmjen e së enjtes.

Trumpi i bëri këto paralajmërimet, pa shpjegime të mëtejshme, disa orë pasi Irani nisi sulme të reja me raketa dhe dronë ndaj Izraelit dhe shteteve të Gjirit, pas një paralajmërimi të mëparshëm nga Trumpi drejtuar Teheranit se duhet "të bëjë një marrëveshje para se të mos mbetet asgjë" nga vendi.

Trumpi vazhdoi të dërgojë mesazhe disi të përziera mbi luftën, pasi një ditë më parë tha në një fjalim televiziv se Bashkuara janë afër "përfundimit të punës" në Iran, por ka paralajmëruar njëkohësisht se ushtria amerikane do të vazhdojnë ta godasin vendin e Lindjes së Mesme "jashtëzakonisht fuqishëm" edhe për "dy deri në tre javë" të tjera.

Në atë fjalim, Trumpi e mbrojt luftën si të nevojshme për ta parandaluar Iranin nga zhvillimi i armëve bërthamore.

Sulmi mbi urën iraniane

Në një postim tjetër në "Truth Social", Trumpi e përshëndeti sulmin amerikan mbi një urë të madhe që lidh Teheranin me Karajn në provincën Alborz, e cila është përshkruar nga mediat iraniane si ura më e lartë në Lindjen e Mesme. "Ura më e madhe në Iran u shemb dhe nuk do të përdoret më kurrë", shkroi Trumpi.

Zyrtarët iranianë thanë se tetë njerëz u vranë dhe 95 u plagosën në dy runde sulmesh mbi urën. Ky numër nuk mund të verifikohet në mënyrë të pavarur.

Irani gjithashtu raportoi se Instituti Pasteur, një qendër kërkimore mjekësore, pësoi dëme të mëdha nga një sulm. As ky lajm nuk mund të verifikohet, megjithëse Qeveria iraniane publikoi një fotografi që pretendohet se tregon dëmet.

Kryetari i fuqishëm i Parlamentit të Iranit, Mohammad Baqer Qalibaf, publikoi një mesazh sfidues në rrjetet sociale: "Iranianët nuk flasin vetëm për mbrojtjen e vendit të tyre, ne derdhim gjak për të. E kemi bërë më parë dhe jemi gatë ta bëjmë përsëri... E jani".

Një zëdhënës ushtarak iranian paralajmëroi për sulme "më të gjera dhe më shkatërruese" në vijim.



Sulme me raketa në Izrael

dëgjuar vinte nga shkatërrimi i predhave, pasi Irani po vazhdon t'i godasë aleatët arabë të ShBA-së në Gjirin Persik.

Ndryshime në krye të ushtrisë amerikane

Sulmet vijnë në një kohë kur një zëdhënës i Pentagonit tha se generali Randy George, shefi i Shtabit të Ushtrisë së ShBA-së, do të dalë në pension nga pozita e tij si oficeri më i lartë i shërbimit. "Gjenerali Randy A. George do të dalë në pension nga pozita e tij si shefi i 41-të i Shtabit të Ushtrisë, me efekt të menjëhershëm. Departamenti i Luftës është mirënjohës për shërbimin e gjeneralit George ndaj kombit tonë për dekada. I urojmë më të mirat në pensionimin e tij", shkroi zëdhënësi në X.

Nuk dihet nëse ky vendim lidhet me luftën në Iran, në një kohë kur

kritikët e Trumpit janë ankuar se konflikti po del jashtë kontrollit dhe po krijon krizë energjetike dhe vështirësi ekonomike në Shtetet e Bashkuara dhe në mbarë botën.

Mediat amerikane, duke cituar zyrtarë anonimë amerikanë, thanë se shefi i mbrojtjes Pete Hegseth e detyroi George të largohet, një veprim pothuajse i paparë gjatë kohës së luftës, sepse ai dëshironte dikë që do të zbatonte vizionin e tij dhe të Trumpit për ushtrinë amerikane.

Shefi i OKB-së bën thirrje për ndaljen e "spirales së vdekjes"

Ndërkohë, sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Antonio Guterres, më 2 prill bëri thirrje për t'i dhënë fund "spirales së vdekjes dhe shkatërrimit" në Lindjen e Mesme. "Jemi në prag të një lufte më të gjerë që do të përfshijë të gjithë Lindjen e Mesme me pasoja dramatike në mbarë globin", u tha Guterres gazetarëve në Nju Jork.

Guterres theksoi rreziqet e gjendjes në Ngushticën e Hormuzit, të cilën Irani e ka mbyllur, pothuajse duke e ndaluar transportin detar duke krijuar një bllokim të cisternave të naftës dhe gazit natyror, gjë që ka çuar në një krizë globale energjetike. "Kur Ngushtica e Hormuzit ngufatet, më të varfrit dhe më të cenueshit në botë nuk mund të marrin frymë", tha Guterres.

KËRKOHET RIHAPJA 'PA KUSHTE' E HORMUZIT, PAS TAKIMIT TË UDHËHEQUR NGA BRITANIA

LONDËR, 3 PRILL - Mbretëria e Bashkuar ka udhëhequr një takim online ku morën pjesë përfaqësuesit e mbi 40 shteteve që diskutuan për krizën e Ngushticës së Hormuzit dhe pas takimit u kërkua "rihapja e menjëhershme dhe pa kushte" e kësaj rruge kyç të tregtisë botërore. Në këtë takim mori pjesë edhe ministri për Punë të Jashtme dhe Diasporë i Kosovës, Glauk Konjufca.

Por, takimi nuk prodhoi ndonjë përparim konkret në këtë çështje. "Irani po tenton ta mbajë peng ekonominë botërore në Ngushticën e Hormuzit. Ata nuk duhet t'ia arrijnë qëllimit", tha sekretarja e Jashtme britanike, Yvette Cooper në një deklaratë. "Për këtë arsye, partnerët sot bënë thirrje për rihapjen e menjëhershme dhe pa kushte të ngushticës dhe respektimin e



parimeve themelore të lirisë së lundrimit dhe të ligjit për detin", shtoi ajo.

Ngushtica e Hormuzit është mbyllur pothuajse plotësisht që nga fillimi i luftës të Shteteve të Bashkuara dhe Izraelit kundër Iranit, që nisi më 28 shkurt, duke

ndikuar në furnizimet botërore të mallrave, përfshirë naftën, gazin e lëngshëm natyror dhe plehurat kimike.

Ndërkaq, kryediplomati kosovar Konjufca përmes një postimi në Facebook përsëriti thirrjen e shteteve pjesëmarrëse në takim

për rihapjen e Hormuzit. "Ndërrerjet në këto rrugë jetike nuk janë vetëm çështje rajonale, por prekin drejtpërdrejt ekonominë dhe stabilitetin e shumë vendeve, përfshirë edhe vendin tonë. Ato ndikojnë në zinxhirët globalë të furnizimit, në çmimet e energjisë dhe në sigurinë ekonomike në përgjithësi. Për këtë arsye, veprimi ndërkombëtar është thelbësor për të garantuar stabilitetin dhe funksionimin normal të këtyre korridoreve strategjike", shkroi Konjufca.

Mbyllja e ngushticës ka çuar në një rritje të ndjeshme të çmimeve të energjisë, përfshirë edhe në Kosovë.

Po ashtu, kryediplomatët dhe përfaqësuesit e mbi 40 shteteve që morën pjesë në takimin online diskutuan për një sërë fushash "të veprimit të mundshëm

kolektiv dhe të koordinuar", tha kryediplomatja britanike Cooper. Kjo mund të përfshijë edhe rritjen e presionit diplomatik, përfshirë përmes Kombeve të Bashkuara, por edhe sanksioneve, tha ajo.

Po të enjten, Këshilli për Bashkëpunim të Gjirit Persik i bëri thirrje Këshillit të Sigurimit të OKB-së që të autorizojë përdorimin e forcës për të mbrojtur Hormuzin.

Bahrejni propozoi një draft-rezolutë që kërkon miratimin e përdorimit "të të gjitha mjeteve" nga shtetet që të sigurohet transporti i lirë përmes Hormuzit.

Megjithatë, kjo masë ka përçarë Këshillin e Sigurimit me 15 anëtarë, ku Rusia, Kina dhe Franca - që kanë të drejtën e vetos - kanë shprehur kundërshtime të forta.

QEVERIA E KOSOVËS MIRATON PROJEKTLIGJIN PËR ÇMIMET TAVAN DHE ATË PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE



EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 PRILL - Kabineti i kryeministrit Albin Kurti i ka kaluar të premtën projektligjet për çmimet tavan dhe për sigurimet e detyrueshme shëndetësore të cilat duhet të dërgohen në Kuvendin e Kosovës për miratim para se të bëhen ligje. Kjo është një përpjekje e re e Kurtit për t'i fuqizuar këto dy ligje, pasi Gjykata Kushtetuese ia kishte rrëzuar që të dy gjatë mandatit të kaluar katërvjeçar.

Projektligji për çmimet tavan, i njohur si projektligji për masat e përkohshme të produkteve themelore në raste të veçanta të destabilizimit të tregut, vjen në një kohë kur rritja e madhe e çmimit të karburanteve në vend ka nxitur frikën për rritje zinxhir të çmimeve, sidomos atyre

bazë.

Vetëm brenda pak javësh çmimi i një litri naftë në pikat e karburanteve në Kosovë ka arritur deri në 1.79 euro, krahasuar me 1.33 euro sa ishte më 3 mars, tri ditë pas nisjes së sulmeve nga ShBA-ja dhe Izraeli kundër Iranit.

Duke folur në mbledhjen e kabinetit të tij për këtë projektligj, Kurti tha: "Po e sjellim për miratim këtë projektligj i cili vjen si përgjigje e domosdoshme ndaj një realiteti e përvoja që qytetarët tanë e kanë përjetuar: rritje të papritura të çmimeve, paqartësi në treg dhe mungesë e mekanizmave për mbrojtje". Projektligji vendos një baraspeshë të domosdoshme ndërmjet funksionimit të lirë të tregut dhe përgjegjësisë së shtetit për ta mbrojtur interesin publik në situata të

jashtëzakonshme, sipas Kurtit. Ligji për Çmimet Tavan ishte shpallur i pavlefshëm nga Gjykata Kushtetuese në vitin 2023, kur gjykata kishte theksuar se ai nuk ishte në përputhje me Kushtetutën e vendit.

Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari - Lila, tha gjatë paraqitjes së projektligjit, se në hartimin e tij e ka marrë parasysh rekomandimet e Kushtetueses. Ajo tha se projektligji i ri përcakton dy lloje të masave të përkohshme: caktimin e marzhës tregtare për shitje me shumicë dhe pakicë, si dhe caktimin e çmimit maksimal të lejuar për produktet bazë.

Ligji i kaluar, tashmë i shpallur i pavlefshëm, i cilësonte produkte themelore: drithërat, bukën, miellin, orizin, pastat,

vajin ushqimor të lulediellit, qumështin, kripën e kuzhinës, vezët e pulës, mishin e pulës, sheqerin kristalor, produktet e higjienës personale dhe lëndët e drurit për djegie.

Ligji për Sigurimet Shëndetësore

Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor u rrëzua nga Gjykata Kushtetuese në janar, pasi ajo gjeti se ky ligj ishte miratuar në mënyrë jokushtetuese. Gjykata tha në vendimin e janarit se Kuvendi e miratoi atë më 5 dhjetor 2024 duke bërë shkeljeve procedurale gjatë procesit ligjberës.

Duke e paraqitur projektligjin e ri të premtën, ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, tha se kjo është "një nga nismat më

të rëndësishme për të ardhmen e shëndetësisë në vendin tonë". Ai tha se përmes këtij ligji do të themelohet një fond i sigurimit të detyrueshëm shëndetësor i Kosovës.

Projektligji përfshin të gjithë popullatën e vendit, synon ofrimin e qasjes universale në shërbime themelore shëndetësore, si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve, theksoi ai. Ai parasheh edhe rregullimin e kontributeve për sigurimin shëndetësor si burim i financimit të kujdesit shëndetësor, i cili do të jetë shtesë mbi financimin e tanishëm nga buxheti i shtetit. Kjo është një përpjekje 10-vjeçare për sjelljen e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor në vend.

Mungesa e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor besohet se i ka dëmtuar të gjithë qytetarët e Kosovës, sidomos shtresat e varfra të shoqërisë dhe grupet e cënueshme, si pensionistët dhe rastet sociale. Shërbimet në institucionet publike shëndetësore në Kosovë ofrohen pa pagesë vetëm për kategori të caktuara, si fëmijët, pensionistët apo rastet sociale, ndërsa për të tjerët vlen bashkëpagesa për kujdes shëndetësor.

Shuma e saj varion - nga 1 deri në qindra euro - varësisht nga shërbimi që merr pacienti.

Për ato trajtime që nuk realizohen në institucionet publike, përgjegjësinë e mbulimit të kostove e ka Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, i cili menaxhohet nga Ministria e Shëndetësisë. Por procedurat burokratike, derisa pacientët t'i marrin mjetet e nevojshme, zgjasin me javë të tëra, e nganjëherë edhe muaj. Prandaj, shumë qytetarë detyrohen t'i përballojnë vetë shpenzimet - qoftë në spitale private, qoftë jashtë shtetit.

Sigurime shëndetësore kanë vetëm ata që i marrin nga kompanitë private.

Në QKUK fillon përdorimi i Bubble testit me TCD për diagnostikimin e stroke-ut

PRISHTINË, 3 PRILL - Ka filluar të përdoret Bubble testi me Doppler transkranial (TCD) në Klinikën e Neurologjisë së Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, një metodë moderne dhe joinvazive që ndihmon në vlerësimin e pacientëve me insult iskemik në tru (stroke).

Ky test përdoret për ta zbuluar praninë e një shunti (komunikimi) djathtas-majtas në zemër, siç është foramen ovale patente (PFO), që në disa raste mund të lidhet me shkakun e stroke-ut,


veçanërisht te pacientët e moshave të reja.

Një rezultat pozitiv rrit dyshimin për kalim jonormal të gjakut dhe ndihmon mjekët në vendimmarrje për vlerësime të mëtejme dhe trajtimin më të përshtatshëm. Në rast se testi rezulton pozitiv, vlerësimi duhet të plotësohet me ekzaminime dhe procedura të tjera diagnostike kardiologjike që janë më invazive, ndërsa në raste të caktuara mund të merret në konsideratë edhe mbyllja e PFO-së me metoda

kirurgjikale.

Përparësitë e këtij testi janë: është i shpejtë dhe joinvaziv, ka ndjeshmëri të lartë për zbulimin e shuntit, ndihmon në sqarimin e shkakut të stroke-ut. Përdorimi i Bubble testit me TCD paraqet një hap të rëndësishëm në avancimin e diagnostikimit të stroke-ut në Klinikën e Neurologjisë në QKUK.

Që nga fillimi i kësaj metode në qershor të vitit 2025 e deri më tani janë kryer 55 raste të tilla, që kanë rezultuar në sukses.





TAKIMET PËR PRESIDENTIN JAVËN E ARDHSHME, LV-ja: DO TË BËJNË ÇMOS QË TË SHMANGEN ZGJEDHJET

Partitë kryesore politike në Kosovë ende nuk kanë bërë ndonjë lëvizje drejt arritjes së një marrëveshje të mundshme për zgjedhjen e presidentit të ri të vendit, pavarësisht se ka një javë që po rrjedh afati rreth njëmuor i vendosur nga gjykata më e lartë e vendit për këtë çështje. Kryeministri i Kosovës dhe lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti, ka thënë të premten se do të ketë takime me liderët e opozitës javën e ardhshme për temën e presidentit. Zyrtarët e kësaj partie kanë theksuar se do të bëjnë çmos që t'i shmangen zgjedhjet e reja parlamentare

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 3 PRILL - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, njëherësh kryeministri Albin Kurti, së shpejti do t'i fillojë përpjekjet për zgjedhjen e presidentit, ka bërë me dije të premten ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia. Derisa kanë edhe 25 ditë afat kushtetues për zgjedhjen e të parit të vendit, Vitia tha se fokusi kryesor i LV-së dhe Kurtit është të shmangen zgjedhjet. "Atë që po e bëjnë kryeministri Kurti dhe Lëvizja Vetëvendosje është që të shmangen zgjedhjet. Njësoj do

të vazhdohet deri në ditën e fundit me takime, propozime dhe çdo mundësi që të shmangen zgjedhjet. Zgjedhjet nuk sjellin rezultat tjetër dhe në këtë drejtim është një humbje në raport me shumë gjëra të mira për qytetarët. Është diçka që nuk do të ndryshojë thellë rezultatit, prandaj pse të shkohet me gjithë këto harxhime shtesë për zgjedhjet dhe rrugëtim të panevojshëm", ka thënë Vitia në një konferencë për medie pas mbledhjes së qeverisë. Për çështjen e presidentit foli edhe partnerja e koalicionit të Kurtit, ministrja e Industrisë,

Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Mimoza Kusari-Lila. Ajo shprehu skepticizëm për zgjedhjen për presidentin, siç tha, pas polemikave të ashpra të enjten në seancën e Kuvendit. "Ajo çfarë pamë dje për prioritetet e qytetarëve nuk përkonte me sjelljet që i patën disa përfaqësues të partive opozitare. Prej largimit nga salla të PDK-së dhe qasja dhe komunikimi i një drejtuesi të një subjekti tjetër opozitar dhe mosvotimi i katër marrëveshjeve ndërkombëtare, disi nuk po e lënë përshtypjen e hapësirës dhe diskursit për bashkëpunim. Në rast të cenimit të këtij raporti në atë formë dhe në atë mënyrë, hapësira për të pasur konsensus të përbashkët po ngushtohet, por jo në kurriz të forcave politike, por të qytetarëve", ka thënë ajo. Megjithatë, Kusari-Lila ka theksuar se Kurti shumë shpejt do të ketë kërkesa dhe takime formale me liderët e opozitës për çështjen e presidentit. "Do të ketë kërkesa edhe për takime formale, por kur hyjmë në tema pak më të lehta që mund të gjejnë zgjidhje dhe kemi atë sjellje, disi po

dekurajohemi për këtë temë që kërkon seriozitet për ta parandaluar procesin zgjedhor. Ftesat dhe diskutimet do të ndodhin, por nëse është ajo frymë që e pamë dje, këtë po e ndiejmë në fakt edhe me keqardhje të madhe që pastaj do të vijë një proces tjetër që nuk është në të mirën e qytetarëve", ka thënë ajo. Javën e kaluar Gjykata Kushtetuese u dha ligjvënësve 34 ditë kohë për ta zgjedhur kreun e shtetit, në të kundërtën vendi shkon në zgjedhje të parakohshme, që duhet të mbahen brenda 45 ditësh. Presidentes së tanishme, Vjosa Osmani, i mbaron mandati më 4 prill dhe ligjvënësit kanë tani kohë deri më 28 prill për ta emëruar pasuesin e saj. Megjithatë, që nga nxjerrja e aktgjykimit për këtë afat, kanë kaluar shtatë ditë, e veprime në drejtim të gjetjes së një zgjidhjeje apo arritjes së një marrëveshjeje për presidentin nuk janë parë në publik. Kryeministri Kurti paralajmëroi se javën e ardhshme do të ketë takime me liderët e partive

politike. "Do të ketë takime në javën e ardhshme", ka thënë Kurti. Politologu Dritëro Arifi vlerëson për REL-in se Lëvizja Vetëvendosje duhet t'i tërheqë dy kandidatët e propozuar për president, Glauk Konjufcën e Fatmire Mullhaxha-Kollçakun, që të krijojë hapësirë për diskutime me partitë e tjera. "Esenca është a do të dërgojnë sinjale paraprake, siç thashë me largimin e atyre kandidatëve. Ata duhet 'të japin dorëheqje' teknikisht, që krijohet hapësirë për negociata më serioze", ka theksuar Arifi, duke shtuar se kësaj diskutimit do të mund të zhvilloheshin në frymë kompromisi. Zgjedhja e presidentit të ri dështoi në fillim të muajit të kaluar pikërisht për shkak të mungesës së një marrëveshjeje mes partive. Glauk Konjufca dhe Fatmire Kollçaku-Mullhaxha nuk u hodhën fare në votim në mungesë të kuorumit. Presidenti i Kosovës zgjidhet me dy të tretat e votave në dy raundet e para apo me 61 vota në raundin e tretë, por nevojiten 80 deputetë në sallë që seanca të mund të

A NGOPET ALBIN KURTI?

Presidenti nuk është thjesht çështje emri, por çështje balancash. Është frika se një parti e vetme po kërkon të kontrollojë gjithçka. Në një sistem demokratik, kjo frikë nuk është e pabazë. Në vend që të kërkojë një figurë që mund të jetë e pranueshme për një spektër më të gjerë politik, Albiun Kurti ka ofruar një zgjidhje që e thellon ndarjen. Në vend që të tregojë leadership përbashkues, po shfaqet si lider që kërkon dominim të plotë.



Imer MUSHKOLAJ

Kosova vazhdon të sillet në një rreth vicioz të mungesës së konsensusit politik, një sëmundje kronike që prej vitesh po e pengon funksionimin normal të institucioneve. Dje partitë nuk arrinin të merren vesh për krijimin e qeverisë, sot nuk po merren vesh për zgjedhjen e presidentit. Ndërkohë që qytetarët presin stabilitet, përgjegjësi dhe maturi, elitat politike vazhdojnë të sillen sikur shteti është një plaçkë që duhet ndarë, jo një përgjegjësi që duhet bartur.

Në këtë histori të gjatë bllokadash dhe pazareve të dështuara, përgjegjësia nuk është e shpërndarë njësoj. Ajo sot bie më së shumti mbi Albin Kurtin dhe Lëvizjen Vetëvendosje. Jo vetëm për shkak të fuqisë që kanë, por për shkak të mënyrës se si po e përdorin atë.

Në të kaluarën, Kurti dhe Vetëvendosje kishin një argument të fortë: mungesa e konsensusit ishte pasojë e kapjes së shtetit nga partitë tradicionale, të cilat e shihnin pushtetin si pronë private. Ata premtonin një politikë ndryshe, një kulturë të re bashkëpunimi, një qasje që do ta vinte interesin publik mbi

interesin partiak. Por sot, kur janë në pozicionin më të fuqishëm që kanë pasur ndonjëherë, duket se po bien në të njëjtën grackë që dikur e kritikonin.

Propozimi që president i vendit të bëhet Glauk Konjufca nuk është thjesht një propozim politik. Është një sinjal. Një sinjal që pushteti nuk mjafton, se duhet edhe më shumë. Se nuk mjafton të kontrollosh qeverinë, por duhet të kesh ndikim të plotë edhe mbi presidencën. Se nuk mjafton të fitosh zgjedhjet, por duhet të minimizosh çdo hapësirë për balancë dhe kontroll. Dhe këtu lind pyetja thelbësore: a ngopet ndonjëherë Albin Kurti?

Në një demokraci funksionale pushteti nuk është qëllim në vetvete. Ai është mjet për të shërbyer. Por kur pushteti fillon të shihet si diçka që duhet grumbulluar pa kufi, atëherë rreziku për demokracinë bëhet real. Sepse demokracia nuk matet vetëm me vota, por edhe me mënyrën se si ushtrohet pushteti pas votave.

Kosova ka nevojë për një president që përfaqëson unitetin – jo një figurë që shihet si zgjatim i një partie të vetme. Ka nevojë për një proces që ndërton besim – jo që

thellon ndasitë. Ka nevojë për kompromis – jo për imponim. Por kompromisi kërkon diçka që politika kosovare shpesh e ka pasur të vështirë: vullnetin për të lëshuar pe. Dhe pikërisht këtu qëndron problemi. Kur një parti ndjehet e fortë, ajo e sheh kompromisin si dobësi. Kur një lider ka mbështetje të madhe, ai tundohet ta përdor atë për të imponuar vullnetin e vet, jo për të ndërtonur ura me të tjerët.

Historia politike e Kosovës është e mbushur me shembuj të tillë. Nga bllokadat e gjata për krijimin e qeverive, te marrëveshjet e brishta që shpesh kanë dështuar, deri te krizat institucionale që kanë lënë pasojë të thella. Dhe çdo herë çmimin e kanë paguar qytetarët.

Sot rreziku është që kjo histori të përsëritet. Që mungesa e konsensusit për presidentin të kthehet në një krizë të re politike. Që vendi të futet sërish në një cikël pasigurie dhe tensioni. E gjithë kjo në një kohë kur Kosova ka nevojë më shumë se kurrë për stabilitet, për fokus dhe për rezultate konkrete.

Nuk është e vështirë të kuptohet

pse partitë e tjera hezitojnë ta mbështesin kandidaturën e Konjufcës. Nuk është thjesht çështje emri. Është çështje balancash. Është frika se një parti e vetme po kërkon të kontrollojë gjithçka. Në një sistem demokratik, kjo frikë nuk është e pabazë.

Në vend që ta zbusë këtë frikë, Kurti duket se po e ushqen atë. Në vend që të kërkojë një figurë që mund të jetë e pranueshme për një spektër më të gjerë politik, ai ka ofruar një zgjidhje që e thellon ndarjen. Në vend që të tregojë leadership përbashkues, po shfaqet si lider që kërkon dominim të plotë.

Kjo nuk është ajo që qytetarët votuan. Ata votuan për ndryshim, për drejtësi, për një qeverisje më të mirë. Ata nuk votuan për një përqendrim të pushtetit që rrezikon të prodhojë të njëjtat probleme që dikur kritikoheshin. Natyrisht, përgjegjësia nuk është vetëm e Kurtit. Edhe partitë e tjera kanë dështuar shpesh të jenë konstruktive. Edhe ato kanë përdorur bllokadën si mjet politik. Edhe ato kanë vënë interesin partiak mbi atë shtetëror. Por dallimi sot është se Kurti ka pushtetin për ta ndryshuar këtë kulturë. Dhe deri më tash nuk po e bën.

Në fund të fundit, çështja nuk është nëse Konjufca është apo jo kandidat i mirë. Çështja është se si po bëhet procesi. A po ndërtohet një konsensus i gjerë? A po respektohen parimet e balancës institucionale? A po krijohet një klimë besimi? Nëse përgjigjet janë negative, atëherë problemi është më i madh se një emër. Është problem i qasjes. Është problem i mënyrës se si kuptohet dhe ushtrohet pushteti. Dhe këtu rikthehem te pyetja fillestare: a ngopet Albin Kurti?

Nëse historia na mëson diçka, është se pushteti rrallë ngopet vetvetiu. Ai ka nevojë për kufij. Për kontroll. Për balancë. Për një opozitë të fortë dhe për institucione që funksionojnë. Për një kulturë politike që e sheh kompromisin jo si tradhti, por si domosdoshmëri. Kosova nuk ka luksin të humbasë kohë në betejë për pushtet, por ka nevojë për një politikë që e kupton se forca e vërtetë nuk qëndron te kontrolli i gjithçkaje, por te aftësia për të ndërtonur marrëveshje. Te aftësia për të dëgjuar. Te gatishmëria për të lëshuar pe. Sepse në fund, nuk është çështje nëse një lider ngopet me pushtet. Është çështje nëse një shoqëri vendos t'i vë kufij atij pushteti.

mbahet.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Artan Abrashi, tha të mërkurën se çështja e zgjedhjes së presidentit varet nga takimet që do të zhvillohen. Sipas tij, Vetëvendosja ka "vullnetin dhe gatishmërinë" të gjejë një kompromis.

"Uroj që (përfaqësuesit e partive opozitare) do të reflektojnë pozitivisht dhe Kosova ta tejkalojë këtë krizë të

panevojshme, e cila ka rrezik që të na çojë në zgjedhje, prapë po them të panevojshme", tha Abrashi për agjencinë e lajmeve "EkonomiaOnline".

Pas publikimit të aktgjykimit të Kushtetueses, kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, tha se përgjegjësia kryesore për çështjen e presidentit mbetet te shumica parlamentare. "LDK mbetet e

gatshme të kontribuojë në çdo përpjekje serioze për zgjidhje, që garanton stabilitet dhe funksionim normal të institucioneve. Por, njëkohësisht, nuk do të bëhet alibi e dështimeve të askujt", ka thënë ai.

Nëse presidenti i ri nuk zgjidhet deri më 4 prill, atëherë detyrën e presidentit do ta ushtrojë kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu. Sipas Kushtetutës, posti

i ushtruesit të detyrës së presidentit nuk mund të ushtrohet për një periudhë më të gjatë se gjashtë muaj.

Marrjen e detyrës nga Haxhiu, politologu Arifi e sheh si një nga arsyet pse Lëvizja Vetëvendosje është duke shtyrë nisjen e diskutimeve me partitë opozitare për zgjedhjen e presidentit. Sipas tij, ndonëse të gjitha partitë politike

deklarohen se janë të gatshme për zgjedhje, koha e mbajtjes së tyre mund të jetë më e përshtatshme për njërin palë sesa për tjetrën. "Mendoj që në këtë rast partia në pushtet po luan me elementin kohë me qëllim që të krijojë presion por, ndoshta, edhe zvarritjen e radhës për caktimin e datës së zgjedhjeve të jashtëzakonshme", ka thënë ai.

ALARMI AMERIKAN PËR SIGURINË NXIT MASA TË REJA DHE PËRPLASJE POLITIKE NË SHQIPËRI

TIRANË, 3 PRILL - Ambasada Amerikane në Shqipëri ka paralajmëruar se grupe të lidhura me Iranin mund të shënjestrojnë subjekte të lidhura me Shtetet e Bashkuara ose elementë të opozitës iraniane në Shqipëri, në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës janë ndërmarrë masa shtesë sigurie.

E ngarkuara me punë në Ambasadën Amerikane, Nancy VanHorn, vizitoi Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës, ku janë vendosur pajisje kontrolli të prodhuara në ShBA. "Bashkëpunimi me ofrues të besueshëm të teknologjisë amerikane i ndihmon kompanitë shqiptare ta përmirësojnë sigurinë dhe ta përforcojnë sigurinë kufitare", u tha në njoftimin e Ambasadës Amerikane në Tiranë. Ambasada u bëri thirrje qytetarëve amerikanë në

Shqipëri "të ushtrojnë vigjilencë të shtuar", ndërsa qeveria shqiptare reagoi duke theksuar se agjencitë ligjzbatuese të Shqipërisë "nuk e kanë asnjë informacion shqetësues lidhur me këtë hamendësim.

Paralajmërimi i Ambasadës Amerikane dhe qëndrimi i qeverisë sollën reagime të institucioneve dhe të politikës. Opozita e cilësoi paralajmërimin shumë serioz dhe kërkoi mbledhjen e Këshillit të Sigurimit Kombëtar, ndërsa shumica, ashtu si qeveria, tha se nuk ka vend për panik.

Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike, Gazment Bardhi, kërkoi gjatë seancës në Kuvend që kryeministri Edi Rama të ishte i pranishëm për të dhënë llogari se çfarë masash janë marrë për ta garantuar sigurinë. "Rama të japë shpjegime pse e cilësoi hamendësim



paralajmërim e ShBA-së, a ka koordinim mes partnerëve ndërkombëtarë për çështjen dhe çfarë informacionesh ka shkëmbyer qeveria shqiptare me ShBA-në, a ka një vlerësim zyrtar të institucioneve shqiptare për situatën e sigurisë?", pyeti Bardhi. Ministri i Punëve të Jashtme, Ferit Hoxha, tha në Kuvend se Shqipëria është në kontakt të vazhdueshëm me ShBA-në dhe NATO. "Ne i ndjekim me shumë vëmendje deklaratat e partnerëve tanë. Jemi në kontakt me ata këtu dhe në Uashington. Jemi në kontakt me NATO-n. Nuk

ka asnjë arsye për të qenë të alarmuar", tha kryediplomati shqiptar.

Edhe ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Ermal Nufi, tha se paralajmërimi i Ambasadës së ShBA-së ishte një njoftim i zakonshëm dhe nuk ka vend për shqetësim.

"Ambasada Amerikane ka bërë thirrjen për të gjithë qytetarët e saj, e bën për të gjithë Evropën. Nuk e ka specifike për Shqipërinë", u shpreh Nufi. Pas debateve në Kuvend, reagoi Presidenca shqiptare, duke theksuar se "presidenti i Republikës është në kontakt të përditshëm me institucionet e Këshillit të Sigurimit Kombëtar dhe informohet prej tij për çdo situatë dhe skenar, si dhe për të gjitha masat që merren në kuadër të protokolleve të sigurisë".

Sipas Presidencës shqiptare, të gjitha institucionet janë vigjilente

dhe në ndjekje të plotë të situatës dhe bashkëpunimi institucional dhe ai me partnerët ndërkombëtarë është në nivele tejet të lartë.

Paralajmërimi i Ambasadës Amerikane erdhi pak javë pasi hakerë të lidhur me Iranin kryen sulme kibernetike ndaj institucioneve shtetërore në Shqipëri, dhe pasi Kuvendi shqiptar e shpalli Iranin shtet sponsor të terrorizmit.

Marrëdhëniet midis Iranit dhe Shqipërisë janë të tensionuara dhe praktikisht të ngrira prej se Shqipëria u ofroi anëtarëve të grupit opozitar iranian, MEK (që njihet edhe si Organizata Popullore Muxhahedine e Iranit), strehë të sigurt, mbi një dekadë më parë.

Shqipëria, po ashtu, e mbështet luftën e Shteteve të Bashkuara dhe Izraelit, kundër Iranit, e cila nisi më 28 shkurt.

PUSHTETI KUNDËRSHTON KËRKESËN E OPOZITËS PËR ULJEN E AKCIZËS DHE HEQJEN TVSH-SË PËR NAFTËN

PRISHTINË, 3 PRILL - Anëtarë të kabinetit qeverisës i kanë kundërshtuar kërkesat e opozitës për uljen e akcizës dhe heqjen e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSh) për naftën gjatë një debati parlamentar të premtën, në një kohë kur çmimet e karburantit janë rritur bujshëm si pasojë e luftës në Lindjen e Mesme.

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) paraqiti një rezolutë për këtë në Kuvend, përmes së cilës i kërkohet qeverisë të gjejë mënyra për ta subvencionuar çmimin e naftës për bujqësinë, transportin publik dhe prodhuesit vendorë. Rezoluta - e cila u mbështet edhe nga dy partitë e tjera opozitare, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) - synon parandalimin e krizës ekonomike dhe sociale në vend si pasojë e çmimit të lartë të naftës.

Në tekstin e rezolutës kërkohet: ulja e akcizës nga 36 centë në litër në 20 centë në litër derisa të stabilizohen çmimet në bursat ndërkombëtare dhe ulja e përkohshme e TVSh-së në karburante nga 18 në 8 për qind

deri në stabilizim të çmimeve.

Kërkesa për këtë rezolutë vjen në një kohë kur rritja e madhe e çmimit të karburanteve në vend ka nxitur frikën për rritje zinxhir të çmimeve, sidomos atyre bazike. Vetëm brenda pak javësh çmimi i një litri naftë në pikat e karburanteve në Kosovë ka arritur deri në 1.79 euro, krahasuar me 1.33 euro sa ishte më 3 mars, tri ditë pas nisjes së sulmeve nga ShBA-ja dhe Izraeli kundër Iranit. Shefja e grupit parlamentar e LDK-së, Jehohna Lushaku Sadriu, tha se rritja e vazhdueshme e çmimit të naftës "nuk është thjesht në lëvizje në treg, por është bazë e një krize ekonomike me ndikim të drejtpërdrejtë në çdo familje dhe çdo biznes të Kosovës". Ajo i ka kritikuar autoritetet se nuk kanë ndërhyrë për të bërë diçka për këtë, duke thënë "qeveria nuk guxon të qëndrojë si spektatore dhe të përfitojë nga rritja e taksave në këto produkte".

Kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, e kritikoi qeverinë se nuk është duke e marrë parasysh "ndikimin e kësaj dukurie në përkeqësimin e



standardit të jetesës të qytetarët". "Kjo qeveri nuk është duke u përkujdesur për zhvillimin ekonomik dhe standardin e jetesës, por është duke bërë veprime vetëm si të konvertohen në votë. Blerjen e votës përmes parasë publike".

Ndërsa shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, tha se qeveria e tanishme "nuk është e aftë" të përballet me krizat. "Duhet ta themi hapur se krizën të cilën sot e kemi në Kosovë, është barra më e madhe për qytetarët e Kosovës dhe se kjo krizë po kthehet në një mundësi të lojës së numrave, gjoja se për zhvillim ekonomik", tha Tahiri.

Megjithatë, rezoluta dhe pretendimet e opozitës u kundërshtuan nga anëtarë të kabinetit të kryeministrit Albin

Kurti të cilët argumentojnë se rekomandimet e tyre nuk janë zgjidhje.

Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, argumentoi sesi, sipas saj, ulja e akcizës apo heqja e TVSh-së nuk janë zgjidhje, duke thënë se ato do të ndikonin në buxhetin e shtetit dhe rrjedhimisht në shtesat për qytetarët. "Tani ju çka po propozoni, ta heqim akcizën, ta heqim TVSh-në? Dhe, cilën nga masat ta heqim? Shtesat për lehonat? Shtesat për fëmijë? Cilën nga kategoritë e caktuara ju mendoni se ne duhet ta ulim që ta kompensojmë për uljen apo heqjen e TVSh-së apo akcizës", tha Kusari drejtuar opozitës.

Ministri i Financave, Hekuran Murati, e akuzoi opozitën se i dëshiron këto masa "jo për qytetarët, por për bizneset që mbështesin partitë tuaja".

Ai argumentoi se ulja e akcizës nuk do të ndikonte te qytetarët kur ata blejnë naftë. "Ulja e akcizës për 16 centë për një familje që shpenzon 50 litra naftë në muaj përkthehet në 8 euro. A ju kujtohet

kur kemi filluar shtesat e fëmijëve me 10 euro, këta [opozita] thoshte se janë vitra, e tash propozimi i tyre është uleni akcizën t'i kursejnë 8 euro në muaj, e për shtetin kjo përkthehet në 10 milionë euro më pak të hyra në muaj", u shpreh Murati.

Qeveria e Kosovës synon që rritjen e çmimeve ta kontrollojë përmes një ligji për çmimet tavan, projektligjin për të cilin pritjet ta dërgojë në Kuvend së shpejti, pasi e miratoi atë në një mbledhje të premtën.

Rreth një javë pasi filloi rritja e çmimeve - kur Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli nisën bombardimet ndaj Iranit më 28 shkurt, dhe Teherani u përgjigj duke goditur Izraelin dhe vendet e Gjirit që strehojnë baza amerikane - Qeveria e Kosovës vendosi masa mbrojtëse për çmimin e derivateve.

Sipas vendimit, marzha tregtare maksimale e lejuar për shitje me shumicë do të jetë deri në 2 centë për litër, ndërkaq me pakicë deri në 12 centë për litër.

Ky vendim është në fuqi vetëm deri më 4 prill.

Më shumë reshje atmosferike më 2025 sesa më 2024

PRISHTINË, 3 PRILL - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar rezultatet e hulumtimit statistikor "Disa fakte mbi mjedisin" për vitin 2025.

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte të ofrojë të dhëna të qëndrueshme statistikore mbi gjendjen e mjedisit në Kosovë. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se në vitin 2025: numri i ditëve me të reshura atmosferike (shi dhe borë) në Prishtinë është rritur në 126 ditë, krahasuar me vitin 2024 që ishin 110 ditë. Pra, në vitin 2025 vërehet se ka pasur më shumë reshje që paraqet një rritje prej 14,5 %. Në

aspektin mujor, në vitin 2025, në muajin tetor dhe nëntor kishte nga 18 ditë reshje krahasuar me vitin 2024, ku numri më i madh i ditëve më të reshura ishte në muajin maj (17 ditë). Qershori në 2025 ishte me zero ditë reshje, pastaj gushti dhe dhjetori kanë pasur numrin më të ulët, me 6 ditë reshje. Në vitin 2025 temperatura minimale mujore ishte në shkurt (-12.7°C), ndërsa temperatura maksimale mujore ishte në muajin korrik (40.2°C). Ndërkaq, në vitin 2024 temperatura maksimale ishte në muajin gusht (38.9°C), kurse temperatura

minimale ishte në janar (-13.9°C). Gjithsej reshjet mesatare vjetore në Kosovë në vitin 2025 ishin 595.2 mm, krahasuar me vitin 2024 ka rënie për rreth 52.1 mm, ose rreth 8,05 %, duke treguar që viti 2025 ishte një vit më i thatë krahasuar më 2024. Gjithsej sipërfaqja pyjore e Kosovës ishte 481 000 ha. Pjesën më të madhe të pyjeve të Kosovës, sipas pronësisë së pyjeve, e përbëjnë pyjet shtetërore (61 %) dhe pyjet me pronësi private (38 %).

Kosova ka 260 zona të mbrojtura me sipërfaqe prej 126 122.75 ha. Nga aspekti i numrit të zonave të

mbrojtura, kategoria më e përfaqësuar është ajo e Monumenteve Natyrore (Kategoria III) me gjithsej 230 zona, që përbëjnë rreth 88,5 % të numrit të përgjithshëm të zonave të mbrojtura.

Në vitin 2025 ka një rritje të sasisë së ujit të prodhuar për 10,9 % ose 203.4 mil.m3, krahasuar me vitin 2024, ku sasia e ujit të prodhuar për sektorin publik ishte 183.4 mil.m3.

Edhe në vitin 2025 rezultatet tregojnë se niveli i ndotjes së ajrit në Republikën e Kosovës mbetet i ngjashëm me vitet paraprake si



rezultat i vazhdimësisë së burimeve kryesore sektoriale të ndotjes.

Të dhënat e monitorimit të cilësisë së ajrit sipas zonës monitoruese: Prishtinë, AKS1, (Prishtinë - IHMK dhe Rilindja, Palaj, Obiliq, Dardhishtë, Kodra e Trimave), mesatare vjetore, PM10, PM2.5, NO2, CO, O3), 2025, µg/m³ (Mikrogramm³).

Kurti rikonfirmon bashkëpunimin me RYCO-n

PRISHTINË, 3 PRILL - Kryeministri Albin Kurti është takuar të premten me drejtorin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor, Vladimir Obradović. RYCO është një nismë e Procesit të Berlinit, e dedikuar për pajtim dhe paqe përmes bashkëpunimit rinor, e frymëzuar nga Zyra Franko-

Gjermane e Rinisë (FGYO). Vitin e kaluar Kosova ishte kryesuese e RYCO dhe Prishtina për herë të parë ishte nikoqire e Forumit Rinor, ku u pritën të rinj nga të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor: Kosova, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia.

Kryeministri Kurti shprehu vlerësimin e tij për forumin e suksesshëm dhe theksoi nevojën për organizimin e më shumë ngjarjeve të tilla në Prishtinë dhe për më shumë projekte të përbashkëta të mobilitetit që kanë fokus posaçërisht edukimin dual si dhe sportin. Ai theksoi

rëndësinë e shkëmbimeve ndërmjet të rinjve në adresimin e narrativave të reme dhe në nxitjen e diskutimeve mbi mundësitë për zhvillim. Kryeministri Kurti ka rikonfirmuar përkushtimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ta mbështetur RYCO-n në misionin drejt



pajtimit e bashkëpunimit ndërmjet të rinjve të rajonit.

MBYLLET AFATI, 140 ZYRTARË NUK E DEKLAROJNË PASURINË

PRISHTINË, 3 PRILL - Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka bërë me dije se mbi 10 mijë e 200 zyrtarë publikë kanë deklaruar pasurinë e tyre brenda afatit ligjor për vitin kalendarik 2025, ndërsa rreth 140 të tjerë nuk e kanë përbushur këtë obligim. Në një përgjigje për "Telegrafin", Agjencia theksoi se procesi i deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë për vitin kalendarik 2025 është zhvilluar në përputhje me afatet e përcaktuara ligjore, duke filluar më 1 mars 2026 dhe përmbyllur më 31 mars 2026. Megjithatë, jo të gjithë e kanë respektuar afatin. Sipas Agjencisë, "bazuar në të dhënat më të fundit të njësive përkatëse të nxjerra nga sistemi më 1 prill, rezultojnë rreth 140 zyrtarë që nuk e kanë përbushur obligimin ligjor për deklarim të pasurisë deri në përmbylljen e afatit më 31 mars 2026".

APK shton se këto të dhëna janë ende preliminare dhe mund të ndryshojnë pas përfundimit të verifikimit.

Agjencia më tutje ka bërë me dije se nuk parashihet shtyrje e afatit për deklarim. "Korniza ligjore që rregullon procesin e deklarimit të pasurisë nuk parashihet afat shtesë për përbushjen e këtij obligimi pa pasoja juridike, ndërsa afati përfundimtar ka qenë 31 marsi", thuhet në përgjigje.

Sa iu përket masave ndëshkuese, APK theksoi se në përputhje me kompetencat e saj ligjore tashmë ka filluar ndërmarrjen e veprimeve përkatëse ndaj zyrtarëve që nuk e kanë përbushur obligimin në afat, duke përfshirë iniciimin e procedurave për shqiptimin e gjobave. "Gjoba në vlerë prej 30 % të pagës mujore aplikohet për të gjithë zyrtarët që nuk kanë respektuar afatin ligjor", ka njoftuar APK.

Në rast se obligimi nuk përbushet as pas masave administrative, paralajmërohen edhe pasoja më të rënda. "Në rastet kur obligimi nuk përbushet edhe pas 15 ditësh dhe pas shqiptimit të masave



administrative siç është gjoba, Agjencia procedon me hapat e mëtejshëm ligjorë, përfshirë përgatitjen e kallëzimeve penale për organet kompetente, ndërsa kjo mund të rezultojë me burgim

prej gjashtë muaj deri në pesë vjet, si dhe konfiskim të pasurisë së fituar në kundërshtim me ligjin" thuhet në përgjigje. Agjencia shtoi se çdo rast trajtohet në përputhje me

dispozitat ligjore dhe, nëse ka bazë të mjaftueshme, procedohet me kallëzime penale si dhe njoftohen institucionet relevante si Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës.

THAÇIT I VAZHDOHET PARABURGIMI NË RASTIN KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË



HAGË, 3 PRILL - Në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK) në Hagë i është vazhduar paraburgimi Hashim Thaçit edhe për dy muaj të tjerë në rastin kundër administrimit të drejtësisë. Në këtë rast, Hashim Thaçi ka të bashkëkuzuar edhe Bashkim Smakajn, Isni Kilajn, Fadil Fazliun dhe Hajredin Kuçin.

Gjykatësi i vetëm në këtë rast gjyqësor, Christoph Gosnell, konstatoi se vazhdon të ekzistojë rreziku real që, në qoftë se lirohet, Thaçi mund ta pengojë ecurinë e procesit dhe të kryejë vepra penale të tjera.

Ditë më parë mbrojtja e Bashkim Smakajt dhe ajo e Hajredin Kuçit kanë njoftuar se nuk do të paraqesin prova në rastin në të cilin Smakaj e Kuçi së bashku me Hashim Thaçin, Isni Kilajn dhe Fadil Fazliun akuzohen për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, raporton "Betimi për Drejtësi".

Të dy këto parashtrime mbrojtja i ka dorëzuar ndaras duke njoftuar se nuk ka ndonjë listë të dëshmitarëve. Ndërsa mbrojtja e Kuçit ka thënë se e rezervon të drejtën që t'i drejtohet gjyqarit gjatë fjalëve

përfundimtare. Ndryshe, nga dy të lartpërmendurit, mbrojtja e Thaçit dhe e Kilajt kanë thënë se do të paraqesin prova, ndërsa ajo e Fazliut tha se nuk do të bëjë një gjë të tillë. Mirëpo Fazliu ka rezervuar të drejtën që përmes mbrojtjes të marrë pjesë në deklaratat hyrëse dhe përmbyllëse në këtë rast.

Në seancën fillestare më 27 shkurt 2026, Hashim Thaçi, Bashkim Smakaj, Fadil Fazliu, Isni Kilaj dhe Hajredin Kuçi janë deklaruar të pafajshëm për veprat penale që u vihen në barrë.

Xhamat e pasmë të errësuar të veturës tashmë lejohen edhe në Kosovë

PRISHTINË, 3 PRILL - Xhamat e pasmë të errësuar tash e tutje lejohen edhe Kosovë, edhe nëse fabrikisht vetura nuk i ka

të tillë. Errësimi i xhamave/vendosja e folive është opsionale, ndërkaq një gjë e tillë bëhet kryesisht për

mbrojtje nga dielli, nxehtësia apo edhe për çështje privatësie. Legalizimi i xhamave të zinj bëhet përmes A-Test në

Qendrën e Automjeteve të Kosovës. Çmimi për vendosjen e folive në xhamat e pasmë të veturës është 80 euro.



Përurohen investimet e efijencës në katër ndërtesa sociale në Obiliq dhe Drenas

OBILIQ, 3 PRILL - Është mbajtur ceremonia e përuimit të punimeve në katër ndërtesa shumë-banesore sociale, përkatësisht në Komunën e Obiliqit dhe në Komunën e Drenasit, në kuadër të projektit: "Zbatimi i Masave të Efijencës së Energjisë për Ndërtesat Shumë-Banesore Sociale".

Projekti zbatohet nga Fondi i Kosovës për Efijencë të Energjisë (FKEE) dhe mbështetet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me përkrahje financiare nga Bashkimi Evropian (90%), si dhe me bashkëfinancim nga

komunat përkatëse (10%).

Me këtë rast, ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, theksoi se ky projekt synon përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët, përmes rritjes së efijencës së energjisë dhe uljes së kostove të energjisë për familjet përfituese.

Nga Obiliqi, ajo bëri të ditur se investimet në dy ndërtesa sociale në fshatin Plemetin kanë rezultuar me ulje të konsumit të energjisë deri në 73%. "Masat e zbatuara janë të plota: izolimi i mureve, ndërrimi i dritareve dhe dyerve, izolimi i çatisë, ndriçimi i ri LED me efijencë të

lartë dhe instalimi i sistemit të ri të ngrohjes. Krahas këtyre, janë realizuar edhe punime të rëndësishme për sigurinë dhe funksionalitetin e ndërtesave, përfshirë riparimin e korridoreve, përmirësimin e instalimeve elektrike, sistemin paralel të ujësjellësit, hidroizolimimin dhe masat kundër zjarrit", ka thënë ministrja Rizvanolli.

Ndërkaq, sa i përket investimeve në dy ndërtesa sociale në Drenas, ministrja theksoi se investimi prej mbi 380 mijë euro ka përmirësuar drejtpërdrejt kushtet e jetesës



për 50 familje, përkatësisht rreth 250 qytetarë. "Këto familje tashmë kanë banesa më komode dhe një ulje të

dukshme të konsumit të energjisë deri në 82%, që përkthehet në kosto më të ulëta të energjisë", ka deklaruar ajo.

PROKURORIA AUTORIZON POLICINË PËR GRUMBULLIMIN E INFORMATAVE LIDHUR ME NJEHSORËT E KEDS-it

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 3 PRILL - Prokuroria Themelore në Prishtinë, përkatësisht Departamenti i Përgjithshëm, ka njoftuar se lidhur me rastin e parregullsisve të dyshuara në njehsorët elektrikë të KEDS-it, ekziston dyshimi se këta njehsorë nuk bëjnë matjen e saktë të energjisë elektrike të shpenzuar. Në këtë drejtim, dyshohet se është kryer vepra penale "Mashtrimi", sipas nenit 323 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Prokurori i Shtetit ka autorizuar Policinë e Kosovës për ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të nevojshme hetimore, me qëllim të sigurimit të grumbullimit të provave shtesë lidhur me këtë rast, përfshirë edhe veprimet ndaj zyrtarëve të KEDS-it.

Prokuroria Themelore në Prishtinë mbetet e përkushtuar për ushtrimin e kompetencave ligjore, duke garantuar zbatimin e ligjit dhe mbrojtjen e interesit publik.

Ndërkaq Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI) ka paralajmëruar gjyba ndaj Kompanisë Kosovare për Distributim të Energjisë Elektrike (KEDS), si pronare dhe shfrytëzuese e njehsorëve



elektrikë, pasi gjeti parregullsi në disa prej tyre.

MINTI tha se është bërë verifikimi i parë i njehsorëve, pas themelimit të komisionit ad hoc për verifikim, dhe është vërtetuar se njehsorët kanë qenë me afat të skaduar të vlefshmërisë, ka pasur devijime me orë dhe ditë, por "matja e energjisë elektrike ka rezultuar të jetë në rregull dhe pa ndikim në saktësinë e konsumit të regjistruar".

Verifikimi laboratorik u bë në

Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës, që funksionon në kuadër të MINTI-t. "Me të marrë raportin e gjetjeve, MINTI do të kërkojë zyrtarisht nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë për marrjen e masave konform devijimeve të konstatuara", tha MINTI.

Ndërkaq Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut - që po ashtu funksionon në kuadër të MINTI-t - "do të shqiptojë gjyba ndëshkimore ndaj KEDS-it, si pronar dhe shfrytëzues i

njehsorëve, për çdo gjetje që lidhet me afatin e skaduar të vlefshmërisë së njehsorëve", u tha në njoftim.

MINTI tha se verifikimet e njehsorëve do të vazhdojnë, teksa komisioni ad hoc veçse ka tërhequr njehsorë elektrikë me orë tarifore të pasaktë.

Ora që shfaqet në njehsorët elektrikë të konsumatorëve në Kosovë është me rëndësi, pasi çmimi i rrymës është i ndryshëm, varësisht se kur shpenzohet.

Në Kosovë ekziston tarifa e lartë gjatë ditës dhe tarifa e ulët gjatë natës. Kjo e fundit në dimër aplikohet në periudhën kohore 22:00-07:00, ndërsa verës gjatë orëve 23:00-08:00. Sipas tarifave aktuale, konsumatorët familjarë që shpenzojnë deri në 800 kilovatë në orë (kWh) paguajnë 9.05 centë për kilovat, ndërsa 15.43 centë nëse e tejkalojnë këtë prag.

Gjatë tarifës së ulët konsumatorët e paguajnë 3.88 centë kilovatin, ndërsa 7.28 centë nëse e tejkalojnë shifrën prej 800 kilovatesh.

Shqetësimet për devijime në njehsorë fillimisht u ngritën nga subjekti opozitar, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe media lokale, "Nacionale", që publikuan gjetjet e hulumtimeve të tyre - rreth 2 mijë mostra në total - për mospërputhjet mes

orës në njehsorët e rrymës me orën lokale.

LDK-ja pretendon se qytetarët janë dëmtuar nga "një skemë e madhe mashtrimi", meqë ata mund të kenë besuar se e kanë shpenzuar energjinë në orët kur zbatohet tarifa e ulët, por me dallimet në kohë ata kanë shpenzuar shumë më tepër.

Ndërkaq, KEDS-i në një konferencë për medie më 1 prill tha se mospërputhjet janë çështje teknike dhe jo manipulim. Sipas kompanisë për shpërndarjen e energjisë, nëse kalimi në tarifë është bërë me disa minuta vonesë, atëherë edhe ka përfunduar më vonë por, në rast të identifikimit të pasaktësive jashtë normave të lejuara, "qytetarët do të kompensohen deri në centin e fundit".

ZRRE, ndërkaq, është zotuar se do të marrë masa në rast të konstatimit të gabimeve në funksionimin e njehsorëve elektrikë.

Debatit për parregullsitë në njehsorë elektrikë vjen në kohën kur ZRRE-ja pritet që më 1 maj t'i shpallë tarifat e reja, që vlejné deri më 31 mars. Shpallja e tyre ishte paraparë të bëhej më 1 prill, por u shty.

Disa operatorë energjetikë kanë kërkuar rritje të tarifave prej 20-përqindësh, por ende nuk është marrë ndonjë vendim.

Takimi i delegacioneve Kosovë - Shqipëri, fokusi në sigurinë ushqimore dhe unifikimin e standardeve

PRISHTINË, 3 PRILL - Në kuadër të vizitës zyrtare të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Shqipërisë në Kosovë të premtën është mbajtur një takim ndërmjet delegacioneve të të dyja vendeve, ku u diskutua për avancimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet të dyja vendeve në sektorin e bujqësisë.

Gjatë këtij takimi u theksua nevoja për shtimin e bashkëpunimit në disa fusha

kyçe, me theks të veçantë në forcimin e sigurisë ushqimore, njohjen dhe unifikimin e certifikatave dhe procedurave, identifikimin dhe bashkëpunimin ndërmjet laboratorëve, zhvillimin dhe harmonizimin e metodave të akreditimit, si dhe fuqizimin e shërbimeve këshillimore për fermerët, përfshirë rolin e Qendrave për Transferim të Teknologjisë Bujqësore (QTTB). Palët u pajtuan që këto prioritetet

do të konkretizohen përmes hapave të përbashkët në periudhën në vijim, me synim rritjen e cilësisë së prodhimit vendor, lehtësimin e qarkullimit të produkteve bujqësore dhe garantimin e standardeve më të larta për konsumatorët në të dyja vendet.

Ky takim vlerësohet hap i rëndësishëm drejt thellimit të bashkëpunimit strategjik ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë në sektorin e bujqësisë.



DËBIMI I SHQIPTARËVE NGA SANXHAKU I NISHIT DHE PRITJA E TYRE NGA ADMINISTRATA OSMANE

Nga: Agron ISLAMI

Si rrjedhojë e Luftës Ruso-Osmane 1877-1878 dhe vendimeve të Kongresit të Berlinit, Vilajeti i Kosovës humbi një pjesë të territoreve verilindore, respektivisht Sanxhakun e Nishit me kazatë e Prokupjes, Kurshumlisë, Leskocit dhe Nishit me një popullsi të përgjithshme prej 165 000 banorësh, nga të cilët, sipas të dhënave zyrtare osmane të vitit 1877, rreth 70 000 banorë - apo 41.01 përqind - ishin shqiptarë të besimit islam (po ashtu edhe Sanxhaku i Pirotit i cili kishte rreth 12 000 banorë shqiptarë myslimanë, iu aneksua Serbisë). Njëherësh, në kuadër të këtyre marrëveshjeve, Vilajetit të Kosovës iu aneksua edhe sanxhaku i Vranjës i cili kishte rreth 25 000 banorë shqiptarë.

Humbjet e njëpasnjëshme të ushtrisë osmane në shekullin XIX, u përcollën me tkurrjen territoriale më të madhe të perandorisë, e cila kishte sunduar plot 500 vjet me Ballkanin e sotëm (Rumelinë). Ajo tanimë nuk kishte forcë t'i mbronte territoret e veta, e as të kundërshtonte vendimet që merreshin në tavolinat diplomatike. Pasojat e këtij realiteti të Perandorisë shkuan në drejtim të myslimanëve shqiptarë, boshnjakë dhe turq, të cilët për herë të parë po përballeshin me presionin e lëshimit të trojeve të veta dhe tanimë sulltani nuk kishte fuqi që t'i mbronte - as nënshtetasit e tij, e lëre më trojet e tyre. Karshi kësaj gjendjeje, sulltan Abdylhamiti i Dytë themeloi komisionin e veçantë (idare-i Umumiyye-i Muhacirin Komisyonu), i cili me ekipet e tij - të cilat ishin aktive në çdo qytet të Vilajetit të Kosovës - kishin përgjegjësinë për pritjen dhe sistemimin e të shpërngulurve nëpër pikat e përcaktuara më herët. Njëherësh, komisionet në fjalë përgatisnin edhe dokumentacionin e nevojshëm për muhaxhirët që do të udhëtonin drejt kryeqendrës osmane.

Referuar të dhënave zyrtare osmane, njëri ndër studiuesit më të njohur mbi temën e muhaxhirëve, Nedim Ipek, ka konstatuar se numri i përgjithshëm i të dëbuarve me dhunë nga zonat e Rumelisë është rreth një milion, ku mbi gjysmë milion kishin vdekur gjatë rrugës si pasojë e masakrave, dhunës, acarit dhe kushteve epidemike me të cilat ishin përballur.

Vilajeti i Kosovës ishte zona më e afërt e sigurt për të ikurit nga dhuna serbe më 1878 dhe kështu Shkupi kishte marrë epitetin e kryeqendrës mikpritëse të



muhaxhirëve nga Sanxhaku i Nishit dhe zonave përreth. Sipas të dhënave zyrtare osmane, nënkuptohet se vala e muhaxhirëve ishte nga rrethet e Nishit, Vranjës, Prokupjes, Kurshumlisë, Leskocit, si dhe nga hapësirat e Bullgarisë së sotme, respektivisht nga Sofja, Qystendili, Dubnica, Orehova etj. Më pas, nga Shkupi shpërndaheshin në qytete të ndryshme të Kosovës, derisa ata që shkonin drejtë qendrës osmane drejtoheshin për në Selanik dhe nga aty për në Stamboll dhe gjetiu. Në të njëjtën kohë, një valë tjetër e muhaxhirëve myslimanë vinte nga Bosnja në Mitrovicën e sotme. Këta kishin ikur nga okupimi austro-hungarez.

Nga deklaratat e muhaxhirëve për anëtarët e komisionit për pritjen e mysafirëve, siç thuhet në këto shkresa, shohim se ata kishin ndërruar më shumë se një vend. P. sh. në regjistrimin e datës 26 dhjetorë 1882, Haliti nga Yrgypi (Prokupje), të cilit i ishte konfiskuar e gjithë pasuria dhe i ishte djegur shtëpia, bashkë me gjithë bashkëvendësit fillimisht ishin vendosur në Nish, por me rënien e Nishit në duar të serbëve ata kishin ikur drejt Shkupit.

Në raportin e datës 1 shtator të vitit 1881, ndër të tjera thuhet: Sot kemi bërë regjistrimin e muhaxhirëve të cilët kanë shpëtuar nga robëria (taht-i esaretiden). Këta mysafirë nga Nishi dhe Shehirkoji (Piroti), të cilët kanë ardhur në Shkup, janë regjistruar me emër dhe mbiemër. Njëherësh, stafi i komisionit ka informuar qendrën për numrin e mysafirëve të cilët

do të udhëtojnë drejt Selanikut me tren dhe për këta është përgatitur dokumentacioni i nevojshëm për udhëtim.

Administrata osmane e dinte fare mire se trevat e humbura më nuk do të riktheheshin nën sundimin e tyre dhe mbi këtë argument mijëra familje të muhaxhirëve që kishin arritur në Shkup, u sistemuan nëpër fshatra dhe qytete të ndryshme të Vilajetit të Kosovës. Njëherësh, me lejen dhe me ndihmën e administratës qendrore u ndërtuan shtëpi për ata që u shpërngulën me dhunë. Sipas telegramit të datës 26 gusht 1879, administrata e Vilajetit të Kosovës, në kërkesën me nr. rendor 146, kërkonte nga qendra (Porta e Lartë) në Stamboll që të ndante 100 000 kurushë për shtëpitë që do të ndërtoheshin në lagjen e dedikuar muhaxhirëve (lagja e muhaxhirëve) në Prishtinë, ku do të akomodoheshin mysafirët. Shtëpi të reja për muhaxhirët ishin ndërtuar edhe në lagjen Jenitepe të Shkupit. Ndërsa, muhaxhirët me gjendje të mirë financiare ndërtimin e shtëpive e kishin bërë vetë. Ky argument dëftohet në regjistrimin e 20 shtatorit 1880 të 529 muhaxhirëve të ardhur nga Nishi, Yrgypi, Berkofca e Leskoci, ku ndër të tjera thuhej se prej 529 të ardhurve, 354 prej tyre ishin vendosur në 100 shtëpi, ndërsa janë në mungesë edhe 41 shtëpi për akomodimin e 175 banorëve të cilët ishin në statusin e mysafirëve. Megjithatë, me përjashtim të 5-6 familjeve që nuk kishin mundësi të ndërtonin shtëpi, rreth 40 familje kishin kërkuar leje për ndërtimin e

shtëpive me vetëfinancim.

Nëse bëjmë një analizë të regjistrimeve osmane të hartuara nga komisioni i muhaxhirëve në Shkup, shohim se një pjesë e mirë e kryefamiljarëve ishin fëmijë të moshës së vogël dhe gra. Po ashtu, brenda një shtëpie muhaxhirësh ishin regjistruar edhe pjesëtarë të familjes së gjerë, sikur daja, halla, teza, apo edhe fqinj dhe bashkëvendës të cilët kishin mbetur pa askënd. P. sh. kryefamiljar i shtëpisë me nr. 9, vendosur në Kaçanikun e Vjetër, ishte Mihanja nga Vranja, e identifikuar si nëna e Ramadanit, të birit të Hajdarit, dhe bashkë me të ishin regjistruar: motra Fatimja - 25 vjeçe, vëllai Rexhepi - 23 vjeç (me probleme shëndetësore) dhe motra tjetër Nexhibeja - 11 vjeçe. Apo shtëpia me nr. 14 për kryefamiljar kishte 15-vjeçarin Rexhep, të birin e Bejazitit nga fshati Bajr i Leskocit, dhe bashkë me të ishin regjistruar nëna Hanifeja - 40 vjeçe, vëllau Mehmeti - 12 vjeç dhe motra Zeliha - 11 vjeçe. Shembujt e shumtë të tillë na sjellin të përfundimi se pushteti sllav kishte asgjësuar qëllimshëm burrat, metodë të cilën e aplikuan edhe në Luftën e Parë Botërore. Janë të mjaftueshme shkrimet e gazetarit rus Trocki, për të krijuar pamjen e dhunës dhe terrorit që kreu mbretëria serbe e kohës. Trocki rrëfeu se, derisa mbreti serb ishte asgjësuar për Kumanovë, hasi në një grup shqiptarësh të zënë rob nga ushtria serbe. Mbreti u ngrit në këmbë nga qerrja dhe me ton të lartë iu drejtua ushtarëve:

Çfarë dobie kanë këta njerëz për mua? Duhet të vriten - jo me


pushkatim, sepse kjo është humbje e municioneve, por me hunj.

Në shkrimin tjetër të botuar në gazetën Kievskaa Mysl të datës 23 dhjetor 1912, Trocki i dha hapësirë rrëfimit të një gazetari serb, i cili ndër të tjera ka thënë: Tre ushtarë kaluan aty pranë. Dëgjova bisedën e tyre. 'Kam vuarë plot shqiptarë', tha njëri, 'por nuk kam gjetur as edhe një qindarkë tek asnjëri prej tyre. Por, kur vrava një bulë (një fshatare e re turke), gjeta dhjetë lira floriri në të'.

Në vazhdim të rrëfimit, për ngjarjet në Ferizaj, citohet rrëfimi i një tetari serb:

'Po pjekim pula dhe po therim shqiptarë. Por, na ka ardhur në majë të hundës, shtoi ai me një psherëtim dhe një gjest mërzie e indiference. 'Megjithatë, ka disa njerëz shumë të pasur mes tyre. Aty afër Ferizajt hasëm në një fshat, një fshat i pasur, me shtëpi si kala. Hymë në njërin prej shtëpive. Pronari ishte një plak i pasur, që kishte tre djem. Pra, ishin katër burra, dhe shumë gra gjithashtu. I nxorëm të gjithë jashtë, i vumë gratë në rresht dhe therëm burrat përpara syve të tyre. Nuk ndodhi asgjë. Gratë nuk shpërthyen në lot. Gati dukej sikur ishin të pandjeshme. E vetmja gjë që kërkuam ishte të lejoheshin të hynin në shtëpi për të marrë gjërat personale. I lamë. Kur dolën, secila prej tyre na solli dhurata të shtrenjta. Pastaj ia vumë flakën gjithë vendit'.

Këto praktika të dhunës dhe persekutimit u përdorën edhe në luftën e fundit të Kosovës, të cilën e kemi të freskët. /Telegrafi/



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Rikthehet gara në Superligë, sot dhe nesër luhen ndeshjet e xhiros së 27

PRISHTINË, 3 MARS - Xhiroja e 27 në elitën e futbollit të Kosovës do të ofrojë disa ndeshje mjaft interesante, ku çdo pikë ka peshë të madhe si për kreun e tabelës, ashtu edhe për mbijetesë. Kjo fundjavë pritet të sjellë emocione dhe surpriza, ku sot (e shtunë) janë programuar tri ndeshje, ndërsa nesër (e diel)

dy të tjera. Të gjitha këto ndeshje pritet të nisin në orën 15:00. Sot, në Podujevë, Llapi pret Ferizajn në një duel ku vendositet synojnë ta shfrytëzojnë terrenin e tyre për të marrë tri pikë të rëndësishme, ndërsa mysafirët kërkojnë të befasojnë. Në Suharekë, Ballkani përballet me Dukagjinin, në një ndeshje ku

favoritët kërkojnë vazhdimësinë, por mysafirët mbeten gjithmonë të rrezikshëm. Një tjetër përballje interesante gjatë të shtunës zhvillohet mes Prishtinës së Re dhe Gjilanit, ku të dyja skuadrat synojnë pikë për objektivat e tyre sezonale. Nesër vëmendja zhvendoset në

Gjilan, ku lideri Drita përballet me Malishevën, në një sfidë që pritet të jetë e fortë, me vendasit që kërkojnë ta mbajnë ritmin në garën për kreun e tabelës. Ndërkohë, në Skenderaj, Drenica pret Prishtinën, në një ndeshje tradicionale ku rivaliteti dhe tensioni janë gjithmonë të pranishëm.



MIRATOHET PROJEKTLIGJI PËR LOJËRAT MESDHEKARE "PRISHTINA 2030"

PRISHTINË, 3 PRILL - Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin për Lojërat Mesdhetare "Prishtina 2030". Miratimi i Projektligjit për organizimin e Lojërave Mesdhetare "Prishtina 2030" shënon një hap të rëndësishëm për Kosovën në drejtim të zhvillimit sportiv dhe afirmimit ndërkombëtar. Institucionet e vendit e kanë cilësuar këtë nismë si një projekt me rëndësi të veçantë publike dhe kombëtare, që pritet të ndikojë në ekonomi, infrastrukturë dhe në imazhin e shtetit në arenën ndërkombëtare. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka vlerësuar rëndësinë e këtij projektligji, duke theksuar bazën e tij dhe standardet që synon të garantojë. "Ky projektligj, i bazuar në marrëveshjen e arritur për organizimin e Lojërave Mesdhetare në Republikën e Kosovës 'Prishtina 2030', është projekt me interes të lartë publik dhe kombëtar. Ai garanton që



organizimi i kësaj ngjarjeje madhore të bëhet me përgjegjësi të plotë institucionale, me standarde të larta transparence, integriteti dhe menaxhimi efikas të fondeve publike. Përmes këtij investimi strategjik, ne jo vetëm që forcojmë infrastrukturën sportive dhe zhvillimin ekonomik,

por e vendosim Kosovën në hartën ndërkombëtare si vend që organizon ngjarje të mëdha me dinjitet dhe profesionalizëm. Ky është një investim në rininë tonë, në sportin tonë dhe në imazhin ndërkombëtar të shtetit. Kjo është një dëshmi e besimit në potencialin tonë dhe vizionit për

një Kosovë që konkurren dhe përfaqësohet denjësisht në skenën ndërkombëtare", ka thënë Kurti.

Ndërsa ministri i Rinisë dhe Sportit, Blerim Gashani, ka dhënë hollësi mbi aspektin financiar dhe organizativ të projektit, duke sqaruar burimet dhe strukturën e financimit. "Përmes këtij ligji qeveria do të miratojë shfrytëzimin e fondeve publike për organizimin e Lojërave Mesdhetare në shumën prej të paktën 253 milionë euro. Ky projektligj rregullon gjithashtu kompetencat e Komitetit Olimpik të Kosovës, të Komunës së Prishtinës, si dhe të komunave të tjera, të cilat do të përmbushin obligimet e tyre në raport me organizimin e Lojërave Mesdhetare 'Prishtina 2030'. Në përputhje me mbështetjen financiare të garantuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në dokumentin e kandidaturës, burimi kryesor i financimit për

organizimin e Lojërave Mesdhetare do të jetë buxheti i shtetit të Republikës së Kosovës. Gjithashtu, konsiderojmë se përmes këtij projektligji do të lejohen mekanizma adekuat për organizimin e ngjarjeve sportive, duke paraparë bashkëpunimin institucional dhe duke siguruar që do të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për realizimin sa më të suksesshëm të tyre", ka thënë Gashani.

Projektligji i miratuar përcakton qartë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve shtetërore, përfshirë Komitetin Olimpik të Kosovës dhe komunat përkatëse, duke krijuar një kornizë të plotë ligjore për organizimin e kësaj ngjarjeje madhore. Pas votimit në Kuvend, hapet rruga për nisjen e përgatitjeve konkrete për Lojërat Mesdhetare "Prishtina 2030", të cilat synojnë ta vendosin Kosovën në mesin e organizatorëve të rëndësishëm të ngjarjeve sportive ndërkombëtare.

ACHRAF HAKIMI ZBULON PSE ZGJODHI MAROKUN PARA SPANJËS



PARIS, 3 PRILL - Ylli i Paris Saint-Germain, Achraf Hakimi, ka zbuluar arsyet që e shtynë ta përfaqësojë Marokun në arenën ndërkombëtare, pavarësisht se ishte ftuar nga përfaqësueset e moshave të Spanjës gjatë kohës së tij te Real Madridi. Në një deklaratë të fundit Hakimi ka treguar se kishte provuar të

stërvitej për disa ditë me Spanjën, por përvoja nuk rezultoi bindëse për të. "Te Real Madridi më thanë: 'Pse nuk shkon të stërvitesh për dy ose tre ditë (me Spanjën) për të parë si ndihesh?' Shkova dhe e provova, por nuk u ndjeva rehat", ka thënë Hakimi.

Mbrojtësi i djathtë ka thënë se

vendimi i tij ishte i ndikuar nga ndjenja personale dhe lidhja familjare. "Vendosa që të vazhdoj karrierën time edhe për hir të babait tim, me Marokun, dhe gjërat shkuan mirë atje. E zgjodha Marokun edhe para se të bashkohesha me ekipin e parë të Real Madridit, një vendim i tillë duhet marrë bazuar në atë që

ndjen", ka thënë Hakimi. Ai ka nënvizuar se zgjedhja nuk lidhet domosdoshmërisht me projektet afatshkurtra të ekipeve kombëtare. "Është më shumë një çështje personale sesa dikush që të bind me një projekt. Sot është një trajner, nesër vjen një tjetër me një mendësi ndryshe", ka thënë Hakimi.

Gattuso jep dorëheqje nga pozita e përzgjedhësit të Italisë

ROMË, 3 PRILL - Trajneri i Italisë, Gennaro Gattuso, ka ndërprerë kontratën e tij me Federata Italiane e Futbollit (FIGC) me marrëveshje të ndërsjellë, pas eliminimit në "play-off" për Kupën e Botës, ka konfirmuar federata italiane në një deklaratë për medie. Gattuso kishte

zëvendësuar Luciano Spalletti në qershor të vitit 2025 duke debutuar si trajner i ri i "Azzurrëve" në shtator 2025, me një fitore bindëse 5-0 ndaj Estonisë.

FIGC-i ka falënderuar Gattuson dhe stafin e tij për "përkushtimin dhe pasionin" që kanë treguar gjatë nëntë

muajve të fundit, duke u uruar atyre "suksese në vazhdimin e karrierës". Italia dështoi të kualifikohej për Kupën e Botës për herë të tretë radhazi të martën në mbrëmje, pasi ka humbur finalen e "play-off"-it ndaj Bosnjë-Hercegovina pas penalltive. Presidenti i FIGC-së, Gabriele Gravina, ka dhënë

gjithashtu dorëheqje pas eliminimit të Italisë, njësoj si edhe shefi i delegacionit, Gigi Buffon. Italia ka planifikuar dy ndeshje miqësore në muajin qershor, por është e pamundur që deri atëherë të emërohet trajner i ri, duke qenë se presidenti i ri i FIGC-së pritet të zgjidhet në qershor.







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

